



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KESHILLI BASHKIAK**

Nr. 1992. prot

Tepelenë, më 3.11.2025

V E N D I M

Nr. 66, datë 31.10.2025

PËR DHËNIE TITULL NDERI

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 31.10.2025, në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 54 pika “m”; Ligjit 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit të RSH” pasi shqyrtoi materialin e Komisionit Këshillimor të Bashkisë Tepelenë,

V E N D O S I

A. Të miratojë dhënien e titujve të nderit si më poshtë:

- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” Z. **Ziflo Tahir Varfi** (Pas vdekjes) me motivacionin: “Për kontribut në mbrojtje të Atdheut si pjesëmarrës në Luftën e Vlorës. Shembull i përkushtimit qytetar dhe profesional në zbatimin me devotshmëri të detyrave.”
- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” Z. **Turabi Halil Halili** me motivacionin: “Organizator perfekt dhe novator i spikatur. Model i komunikimit me qytetarët dhe qytetar model në komunitet.”
- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” Z. **Skender Alisha Muça** (Pas vdekjes) me motivacionin: “Për cilësi të larta profesionale drejtuese dhe organizuese në fushën e bujqësisë si dhe për kontributin e dhënë me vlera dhe ndikim pozitiv në sektorët përkatës në rrethin e Tepelenës.”

B. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit Kulturës dhe Kujdesit Social.

C. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore.”

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 11 (njëmbëdhjetë) vota
Vota Pro 11 (njëmbëdhjetë) vota
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 2 (vota)
Zbardhur më datë 3.11.2025

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI

